



BULETINI

Tetor 2010

Numër 8/2010

Përmbajtja

1. Aktivitet nga Programi i vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

2. Trajnim stafi i IGJK

3. Aktivitet nga Programi i Trajnimeve të Avancuara (PTA)

4. Aktivitetet për Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

ZHVILLIM
PRSIONAL
GJYQËSOR

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.
"Muharrem Fejza" pa.nr.
Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069
+381 (0) 38 512 081 +381 (0) 38
512 095 www.kjijudicial.org
info@kjijudicial.org

1. Aktivitet nga Programi i vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

Trajnim: Penale E Drejta e BE-së IGJK & TWINNING



- Të Drejtën Evropiane-Historia e saj,
- Struktura organizative e Bashkimit Evropian,
- Lidhja në mes të Drejtës Evropiane dhe Konventës Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,
- Burimet e së Drejtës Evropiane,
- Epërsia e së Drejtës Evropiane mbi të Drejtën Kombëtare, si dhe
- Liritë fundamentale në të Drejtën Kombëtare.

IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështetë reformimin e sistemit të arsimimit ligjor në Kosovë, më 27 shtator deri më 01 tetor 2010, mbajti një trajnim për të Drejtën e BE-së me temën e lartpërmendur. Në këtë trajnim u trajtuan çështjet lidhur me:

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan shumë shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si dhe u bë analizimi i këtyre rasteve nga pjesëmarrësit. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të cilët punojnë në lëmin penale dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës

2. Trajnim stafi i IGJK

Më 04 dhe 05 Tetor 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar një tryeze pune për stafin e IGJK-së me temë "Përmirësimi (Mprehja) e shkathtësive tuaja".

Gjatë kësaj tryeze pune Këshilltarja Speciale e OSBE-së në Institutin Gjyqësor të Kosovës zhvilloi një program trajnimi për trajnuesit dhe stafin e IGJK-së. Qëllimi i tryezës

ishite ilustrimi i metodologjisë së mësimdhënies dhe inkurajimi i tyre që të vazhdojnë të përdorin debatet, luajtjen e roleve, demonstrimet e ndryshme, grupe te vogla diskutimi dhe metoda tjera interaktive të mësimdhënies kur trajnohen gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës. Hartimi i raporteve gjatë punës ishte gjithashtu njëri nga aspektet e trajtuara gjatë tryezës.

Tryezë Pune-Penale: Dëshmitarët dhe Ekspertet në Procedurën Penale

Instituti Gjyqësor i Kosovës më 05 tetor 2010, organizoj një tryezë pune në lëmine penale me temë “Dëshmitarët dhe ekspertët në procedurë penale”.

Ndër objektivat kryesore të kësaj teme ishin: përkufizimi i nocionit të dëshmitarëve dhe ekspertëve, klasifikimi i dëshmitarëve të cilët nuk merren në pyetje dhe ata që janë të liruar nga dëshmia sipas Kodit të Procedurës Penale, shqyrtimi i procedurës dhe teknikave të marrjes në pyetje të dëshmitarëve si dhe njohja me rëndësinë e ekspertizës mjeko-ligjore.

Në kuadër të kësaj teme janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me shqyrtimin e të drejtave dhe obligimeve të dëshmitarëve dhe ekspertëve, situatat kur bëhet ballafaqimi i dëshmitarëve si dhe është ofruar një përmbledhje për rolin dhe rëndësinë e ekspertit mjeko-ligjor sikurse që është trajtuar edhe për rastet kur ekspertiza është e obliguar.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Seminar: E Drejta Kushtetuese Procedura para Gjykatës Kushtetuese



IGJK më 08 tetor 2010, ka mbajtur seminarin nga lëmia kushtetuese me temë “**Procedura në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**”. Objektivat kryesore të këtij seminari ishin: Identifikimi i rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos për çështjet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar, klasifikimi i subjekteve të autorizuar për të filluar këtë procedurë,

Objektivat kryesore të këtij seminari ishin:

Identifikimi i rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos për çështjet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar, klasifikimi i subjekteve të autorizuar për të filluar këtë procedurë, shpjegimi i rasteve kur deputetët kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi.

Me këtë rast janë trajtuar temat si; heqja dorë e palës nga procedura në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, përmbartimi i vendimeve, rastet kur gjyqtarët kanë të drejtë t’i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje lidhur me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji si dhe u diskutuan raste nga praktika gjyqësore aktuale në Gjykatën Kushtetuese.

Qëllimi i seminarit ishte avancimi i njohurive të përfituesve lidhur me procedurën para Gjykatës Kushtetuese.

Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Program Trajnimi për Trajnues: Standardet Ndërkombëtare dhe Vendore për Barazinë Gjinore në Kosovë dhe Përmirësimi i Shkathtësive Trajnuese



Më 09 deri 11 Tetor 2010, IGJK në bashkëpunim me UNIFEM-in, realizoj një program trajnimi tre ditor për trajnues të IGJK-së. Temë e këtij programi trajnues ishin: **“Standardet Ndërkombëtare dhe Vendore për Barazinë Gjinore në Kosovë dhe Përmirësimi i Shkathtësive Trajnuese”**.

Objektivat mësimore ishin përgatitur me qëllim që pas përfundimit të këtij programi trajnues, pjesëmarrësit do të ishin në gjendje që të; identifikojnë sistemin kyç global të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të kuptojnë konceptet për të drejtat njerëzore të grave dhe barazinë gjinore, të zhvillojnë më tutje shkathtësitë trajnuese në përgatitjen e një punëtorie trajnuese si dhe të bëjnë hartimin e objektivave të caktuara mësimore. Temat e shtjelluara janë përqendruar në legjislaturën juridike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore, rolin e Shkollës së Magistraturës të Shqipërisë në hartimin e Udhëzuesit për barazinë gjinore, objektivat mësimore, rëndësinë e të mësuarit interaktiv, si të organizohen diskutime të efektshme në grup si dhe, ushtrime praktike lidhur me përfitimim e këtyre shkathtësive trajnuese. Qëllimi i përgjithshëm ishte që të zhvillohen njohuritë e pjesëmarrësve mbi mekanizmat ndërkombëtare dhe vendore për të drejtat njerëzore me fokus në të drejtat njerëzore të grave dhe barazinë gjinore si dhe, zhvillimi i shkathtësive trajnuese për këto çështje. Përfitues të këtij trajnimi ishin trajnuesit aktual dhe potencial të IGJK-së.

Tryezë Pune Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale IGJK & NCSC/USAID

Më 12 tetor 2010, IGJK në bashkëpunim me Programin për Përkrahje Sektorit të Drejtësisë në Kosovë, USAID/NCSC, realizoj një tryezë pune lidhur me etikës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë.

Për realizimin e suksesshëm të kësaj tryeze pune objektivat mësimore ishin dizajnuar në atë mënyrë që pjesëmarrësit të janë në gjendje që të klasifikojnë shkeljet etike, të përshkruajnë veprimet e tyre në raport me mediat, të shpjegojnë rëndësinë e kodit të etikës si një instrument për garantimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Gjatë tryezës janë trajtuar çështje të rëndësishme lidhur me kodin e etikës duke u përqendruar në rregullat e normuara nga ky kod, të cilat përcaktojnë sjelljen standarde për garantimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pastaj u diskutua se cili është raporti me media si dhe është demonstruar një rast praktik përmes luajtjes së roleve.

Kjo tryezë pati një sukses të shkëlqyeshëm dhe kjo tregohet me faktin e prezencës dhe interesimit të pjesëmarrësve në parashtrimin e pyetjeve dhe shembujve praktik me qëllim të interpretimit

profesional nga trajnuesit.

Përfitues ishin, gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional dhe administrator nga të gjitha regjionet e Kosovës



Tryezë Pune Ligji për Arbitrazh IGJK-SEAD/USAID



IGJK në bashkëpunim me USAID/SEAD-Programi i Mbështetjes së Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve, më 12 tetor 2010, ka mbajtur një tryezë pune me temë

“**Ligji për Arbitrazhin**”. Objektivi i kësaj tryeze ishte që gjyqtarët, të jenë në gjendje që të zbatojnë konceptet kryesore të arbitrazhit, të interpretojnë dhe shqyrtojnë qëllimin e fushëveprimit të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin, të përcaktojnë kufijtë e juridiksionit të gjykatës, të hartojnë marrëveshjen e arbitrazhit ose vendimin, të dallojnë rregullat lidhur me ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit. Qëllimi i kësaj tryeze ishte që gjyqtarëve t’u sqarohen parimet kryesore lidhur me zgjidhjen e kontesteve përmes procedurës së arbitrazhit dhe për të ndihmuar ata në interpretimin e instrumenteve të zbatueshme ligjore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmis civile, të të gjitha regjioneve të Kosovës, gjyqtarë të Gjykatës Ekonomike si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Trajnim TOT Ndërtimi i Shkathësive të përfaqësimit gjate Gjykimit IGJK-US DOJ

Me 12-13-14 Tetor 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve dhe Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë - Instituti Kombëtar i Avokimit (mbështetje) gjatë Gjykimit (“NITA”) ka organizuar një tryezë pune për : “Shkathësitë e Përfaqësimit në Gjykim”.

Kjo tryezë pune është projektuar për të përmirësuar dhe zhvilluar edhe më tej Shkathësitë e Përfaqësimit gjate Gjykimit të prokurorëve.

Trajnues me përvojë nga Instituti Kombëtar i Avokimit (mbështetje) gjatë Gjykimit (“NITA”) – nga SHBA-të, kanë ligjëruar dhe kanë demonstruar përvojat e tyre si trajnues mbi shkathësitë e veçanta të prezantimit të rasteve në gjykim at the time.

Secili pjesëmarrës u familjarizua me hetimin e një vjedhje të përbërë nga raportet policore, ekspozita, deklaratat e dëshmitare etj.



Gjate këtij trajnimi treditor instruktoret kanë diskutuar për ekzaminimin e drejtpërdrejtë, ekzaminimin e tërthortë, vënien në dyshim të dëshmitarit, paraqitja e materialeve për provat dhe fjala përfundimtare.

Pjesëmarrës në këtë seminar ishin: gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë.

Tryezë e Diskutimeve Civile: Terminologjia Juridike në Procedurë Gjyqësore

Më 12 tetor 2010, IGJK, ka realizuar tryezën e diskutimeve në lëmine civile me temë **“Terminologjia Juridike në Procedurën Gjyqësore”**.

Në këtë tryezë para se gjithash janë paraqitur objektivat kryesore, me synim që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të shpjegojnë drejtë nocionet e terminologjisë juridike civile, kushtetuese, administrative e të punës si dhe, ti zbatojnë ato sa më drejtë në praktikë.

Temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në shpjegimin e rolit dhe rëndësisë së unifikimit të terminologjisë juridike, në lëmin civile, kushtetuese, administrative dhe atë të punës.

Me vëmendje të veçantë u diskutuan edhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në përdorimin e kësaj terminologjie juridike në praktikë.

Qëllimi kryesor i kësaj tryeze ishte ngritja e njohurive lidhur me unifikimin e terminologjisë juridike dhe vendimeve gjyqësore si dhe identifikimi dhe eliminimi i termave të ndryshëm për nocione të njëjta.

Efekti i këtij trajnimit do të arrihet kur gjyqtarët të praktikojnë një kulturë juridike të mirëfilltë dhe të qëndrueshme e cila favorizon terminologjinë juridike që ka saktësi profesionale dhe qartësi gjuhësore.

Kjo tryezë ishte me dobi të shumëfishtë edhe për faktin se sot në Kosovë mungon praktika e shkruar gjyqësore, andaj kjo ishte një përpjekje në funksion të unifikimit të terminologjisë juridike për gjyqtarë. Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarët nga Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, Gjykata Komunale si dhe prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës.

Seminar Civile: Kontrata e Ndërtimit



IGJK në bashkëpunim me USAID/SEAD-Programi i Mbështetjes së Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve, më 15 tetor 2010, organizoj seminarin një ditë me temë, **“Kontrata e Ndërtimit”**. Objektivat mësimore ishin përcaktuar ashtu që pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të; përshkruajnë kornizën e përgjithshme ligjore për ndërtimet në Ligjin e fuqi, Detyrimeve të Kosovës dhe aktet e tjera

ligjore në fuqi shpjegojnë disa nga dispozitat e Ligjit për Ndërtimet në Kosovë, precizojnë elementet thelbësore të kontratës për ndërtimin, llojet e kontratave si dhe mënyrat e shuarjes së tyre.

Gjithashtu, me kujdes të veçantë janë trajtuar temat si; nocioni, karakteristikat, natyra juridike e kontratave për ndërtimin, kontrata mbi ndërtimin në LMD, Jurisdikcioni i gjykatave, lidhja e kontratave dhe burimet juridike të kontratës për ndërtimin dhe klauzolat, llojet e veçanta dhe mënyrat e shuarjes së kontratës për ndërtimin.

Pjesëmarrësve të trajnimit iu është shpërndarë një udhëzues lidhur me temën e trajtuar, i cili përmban informacione lidhur me termat, konceptet, ushtrimet dhe shembujt.

Përfitues ishin gjyqtarët e lëmis civile nga niveli komunal dhe i qarkut, si dhe administratorë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Tryezë Pune: Penale Mbrojtja e të Dëmtuarve dhe Dëshmitarëve

Më 19 tetor 2010, IGJK, organizoj një tryeze pune në lëminë penale kushtuar “**Mbrojtjes së të Dëmtuarve dhe Dëshmitarëve**”. Objektivat mësimore për këtë temë ishin hartuar në atë mënyrë që pjesëmarrësit të janë në gjendje të bëjnë identifikimin e kohës së aplikimit të masave mbrojtëse, kategorizimin e këtyre masave, vlerësimin se kur kërkohet anonimiteti i plotë apo i pjesshëm i personave që paraqesin dëshminë e tyre. Qëllimi i tryezës ishte eliminimi i disa dilemave që paraqiten me rastin e mbrojtjes së të dëmtuarve dhe

dëshmitarëve. Përveç trajtimit të veçantë të temave nga paneli drejtues dominoj edhe diskutimi interaktiv me të gjithë të pranishmit lidhur, me masat mbrojtëse ndaj dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, kohën e shfaqjes së rrezikut serioz ndaj tyre dhe anëtarëve të familjes së tyre si dhe, procedurën e nevojshme për lëshimin e një urdhri për masa të tilla mbrojtëse, të gjitha në këndvështrim të rëndësisë praktike. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Tryezë e Diskutimeve :Civile Shpërblimi i Dëmit Jo material nga Autopërgjegjësia IGJK

Më 21 tetor 2010, IGJK ka mbajtur tryezën e diskutimeve me temë “**Shpërblimi i Dëmit nga Autopërgjegjësia**”. Qëllimi kryesor i kësaj tryeze ishte ngritja e njohurive të gjyqtarëve për zbatimin e kritereve për lartësinë e kompensimit të dëmit material dhe jo material nga autopërgjegjësia, zbatimin e kritereve ligjore të drejta për lartësinë e kompensimit të dëmit material dhe jo material, të cilin kompanitë e sigurimeve në Kosovë i kanë aprovuar në formë të kritereve të zbatueshme nga data 01 nëntor 2001 si dhe ngritja e njohurive mbi kriteret në kuadër të EU-së që janë të pasqyruara në direktivat e EU-së (veçmas Direktivës së pestë të EU-së të vitit 2005).

Objektivat e kësaj tryeze ishin që gjyqtarët të jenë në gjendje të; shpjegojnë dispozitat ligjore mbi shpërblimin e dëmit për shkak të frikës; zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për kompensimin e dëmit për shkak të dhembjeve shpirtërore, shëmtimit dhe vdekjes, vlerësojnë rolin e mendimit të ekspertit në bindjen e tyre . Me këtë rast janë trajtuar temat si; shpërblimi i dëmit nga autopërgjegjësia, shpërblimi i dëmit për shkak të frikës dhe formave të tjera të dëmit material si dhe u diskutuan vështirësitë me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zgjidhjen e rasteve praktike nga kjo fushë. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile.

Trajnim: Ndërtimi i Shkathtësive të përfaqësimit gjate Gjykimit IGJK-US DOJ



Më 25 deri më 27 tetor 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve, OPDAT, dhe Institutin Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (NITA) nga SHBA-të, ka realizuar një me

tryezë pune tre ditore temën “**Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit**”. Çështjet të cilat u trajtuan në këtë sesion kryesisht kishin të bënin me teknikat e marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, të tërthortë, vënien në dyshim dhe rimarrjen në pyetje të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, si dhe teknikat e paraqitjes së fjalës hyrëse dhe argumentimit përfundimtar, si nga ana e prokurorit ashtu edhe nga ana e avokatit mbrojtës. Ndërkaq, pjesëmarrësve përmes punës në grupe ju mundësua të demonstrojnë shkathtësitë e tyre të përfaqësimit gjatë gjykimit, duke punuar rreth një rasti praktik dhe duke përdorur teknikat e prezantuara nga trajnuesit për këtë trajnim. Gjithashtu, të gjitha prezantimet e pjesëmarrësve janë incizuar, me qëllim të marrjes së sugjerimeve dhe udhëzimeve për paraqitjen e tyre dhe përfitimim e këtyre shkathtësive teknike.

Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

3. Aktivitet nga Programi i Trajnimeve të Avancuara (PTA)

Programi i Trajnimeve për Avancim Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor



Më datën 12,15,19,26 dhe 29 tetor 2010, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Projektin për Mbështetje Drejtësisë në Kosovë (NCSC) e përkrahur nga USAID-i, në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim, realizoi disa sesione trajnuese me temën e lartpërmendur.

Gjatë trajnimeve janë trajtuar çështjet të cilat kanë të bëjnë me rëndësinë e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, përdorimi i gjuhës ligjore dhe evolucioni i saj, hapat që duhet ndjekur për hartimin e një dokumenti ligjor dhe kategoritë e shkrimit ligjor. Gjithashtu, është trajtuar edhe metoda IRAC (problemi, ligji, analiza, praktika) si mjet për identifikimin e problemit ligjor dhe për të analizuar atë e cila është demonstruar edhe nga ana e pjesëmarrësve përmes ushtrimeve praktike. Qëllimi i këtij trajnimi ishte hartimi dhe arsyetimi i plotë i vendimeve gjyqësore në mënyrë më cilësore në kuptim të ligjit, por edhe të rregullave drejtshkrimore. Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtarë të gjykatës supreme dhe të qarkut si dhe prokurorë të prokurorisë së shtetit.

Programi i Trajnimeve për Avancim Krimi i Organizuar

Instituti Gjyqësor i Kosovës në kuadër të këtij programit për avancim, gjatë muajit shtator në datat 14,17,21,24,28 si dhe, më 01 tetor 2010, realizoj me sukses disa sesione trajnuese me temë “Krimi i Organizuar”.

Objektivë kryesore e trajnimit të tillë ishte, identifikimi i veprave penale të klasifikuara në kuadër të krimit të organizuar si dhe, zbatimi i masave për luftimin e krimit të organizuar në funksion të zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Po ashtu, më vëmendje të veçantë janë trajtuar çështje e rëndësishëm si:

Korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore, ekonomia joformale dhe pastrimi i parave, si dhe masat për luftimin e krimit të organizuar siç janë; masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, dëshmitarët bashkëpunues, dëshmitarët e mbrojtur dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë.

Këto sesione trajnuese kanë qenë të dedikuara për gjyqtarë të gjykatës supreme dhe të qarkut si dhe prokurorë të prokurorisë së shtetit të cilët edhe ishin përfitues të këtyre trajnimeve.



Programi i Trajnimeve për Avancim Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale



GJK me datën 28 shtator dhe 1, 5, 8, 15 dhe 19 tetor 2010, organizoj disa sesione trajnuese në të cilat u trajtua “Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale”.

Në këto sesione, me përkushtim të lartë janë trajtuar, institutet juridike që kanë të bëjnë me dënimin me kusht, gjysmëlirinë dhe paraburgimin, vrasjen e rëndë, konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me veprë penale, mbrojtjen e detyruar, rregullat e marrjes së provës dhe shpallja e aktgjykimit, paralajmërimi i ankesës dhe ankesa e prokurorit si dhe në fund për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të KPPK-së. Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte, avancimi i njohurive për prokurorët dhe gjyqtarët, në hetimin e veprave penale, hartimin e aktakuzave dhe paraqitjen e ankesave më cilësore, hartimin më të mirë të vendimeve gjyqësore, arsyetimin e tyre më të mirë dhe ngritjen e shkathtësive për udhëheqjen e shqyrtimeve gjyqësore. Përfitues të këtij sesiioni trajnues ishin gjyqtarë të gjykatës supreme dhe të qarkut si dhe prokurorë të prokurorisë së shtetit.

Programi i Trajnimeve për Avancim Organizimi i Sistemit Gjyqësor dhe Kompetencat e Nivelit Përkatës

Më 5 dhe 8 tetor 2010, IGJK realizoj sesionin trajnues të radhës me temën: “Organizimi i Sistemit Gjyqësor dhe Kompetencat e Nivelit Përkatës”.

Objektivat kryesore të këtij trajnimi ishin dizajnuar në atë mënyrë përfituesit e trajnimit të analizojnë dhe krahasojnë sistemin gjyqësor nëpër fazat në të cilat ka kaluar gjatë dekadës së fundit, si dhe, të identifikojnë rastet kur në sistemin e tanishëm gjyqësor janë kompetent gjyqtarët e EULEX-it.

Gjatë këtyre trajnimeve objekt trajtimi ishte struktura organizative dhe kompetencat e gjykatave pas luftës nën misionin e administrimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it, në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës. Përfitues të këtij sesiioni trajnues ishin gjyqtarë të gjykatës supreme dhe të qarkut si dhe prokurorë të prokurorisë së shtetit.

Programi i Trajnimit për ndërmjetës dhe referentët përmbaues “Rolet dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve, Referentëve, Palëve dhe Palëve të treta”

Më 13 tetor 2010 në Klinë dhe më 15 tetor 2010 në Prishtinë, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Projektin për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë USAID/NCSC si dhe, Programin Holandez për Reformimin e Përmbaimeve në Ballkan organizoj, trajnime me temë: “Rolet dhe Përgjegjësitë përkatëse të gjyqtarëve, referentëve, palëve dhe palëve të treta”.

Si rezultat i këtyre sesioneve trajnuese zyrtarët përmbaues do të jenë në gjendje të, identifikojnë rastet kur përmbarimi në situata faktike është i pamundshëm për shkak të pengesave ligjore në ligjin aktual të përmbaimit, krahasojnë sistemin e përmbaimit në Kosovë

me vendet tjera në rajon, dhe të kuptojnë për sistemin dy shtresor të përmbaimit, sistemin privat dhe sistemin gjyqësor në disa shtete në rajon si dhe iniciativat për reformë në Ballkan për përmbaimin.

Ndërsa, çështjet të cilat kanë qenë objekt diskutimi ishin; parimet e përmbaimit, qëllimi dhe rolet e kreditorit dhe debitorit, taksat dhe shpenzimet procedurale, rolet e gjyqtarëve dhe referentëve sipas ligjit aktual si dhe, perspektiva evropiane e përmbaimit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive profesionale mbi procesin për përmbaimin e lëndëve dhe përmbaimi i vendimeve gjyqësore në kohë të arsyeshme. Përfitues ishin zyrtarët përmbaues të të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës.

4. Aktivitetet për Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

Programi trajnues “Menaxhimi i Gjykatave dhe Mekanizmat”, në Republikën e Turqisë për kandidatët e PFAL nga data 17-31 tetor 2010

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Akademisë Gjyqësore të Turqisë nga data 17 deri me 31 tetor është organizuar një program trajnimi në Republikën e Turqisë. Programi trajnues është organizuar për kandidatët e gjeneratës së dytë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor të cilët aktualisht janë duke ndjekur trajnimet në fazën e tretë (fazën e mentorimit). Përveç kandidatëve në këtë trajnim morën pjesë 2 Koordinatorët e Mentorëve, 5 anëtarë të stafit të IGJK-së si dhe kryeprokurori i shtetit i cili i është .

bashkëngjitur grupit tri ditët e fundit të programit Në kuadër të këtij programi trajnues kandidatët kanë përcjellë ligjërata nga gjyqtarë, prokurorë dhe ekspert tjerë të drejtësisë si dhe kanë realizuar shumë vizita nëpër institucione të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Turqisë gjatë të cilave janë shkëmbyer shumë informata të rëndësishme për kandidatët dhe për vet sistemin gjyqësor të Kosovës. Realizimi i këtij programi trajnues u mundësua me mbështetjen financiare të Akademisë Gjyqësore të Turqisë.